

Me emrin e Mëshiruesit dhe Mëshirbërësit

Kurra hafiz Aziz Alili

Shijak më,26.01.2011.

KUR'ANI, LUTJA DHE GNOSTIKA (NJOHJA)

Të nderuar të pranishëm, më lejoni që t'ju përshëndes dhe të shpreh kënaqësinë time të madhe e të sinqertë që më jepet mundësia të shpreh disa mendime modeste për këtë temë të rëndësishme dhe bashkëkohore.

SHKURT PËR KUR'ANIN

Librin e shenjtë të Islamit, të njohur në gjuhën arabe me shumë emra nga të cilët më i njohuri është Kur'ani, në kuptimin e të lexuarit, të recitimit; të gjithë muslimanët pa marrë përasysh se cilës shkollë interpretimi i përkasin, qofshin sunni apo shii, e gjykojnë si shpallje hyjnore, fjalë të Zotit, të reveluara {të vendosura} në zemrën, shpirtin dhe mendjen e të Dërguarit të Islamit Muhammedit s.a. nëpërmjet engjëllit të madh Xhibrilit. Edhe fjalët edhe vetë teksti i kuptimit të Kur'anit janë të shenjta si cdo gjë që lidhet me Kur'anin, ashtu sic është i shenjtë edhe shqiptimi i fragmenteve {ajeteve, verseteve} ose kopjimi i tij, kaligrafia nga fjalët e arta të tij. Cdo musliman lind me ajetet {versetet} e këtij libri. Ai u lexohet {fëmijëve} në vesh menjëherë pas lindjes, Kur'ani u lexohet kur fillojnë shkollën ose me raste të tjera të shënuara. Kur'ani recitohet edhe në gëzime dasmash dhe njëherazi kur është duke vdekur ndonjë njeri.

Kurani është qendra e teologjisë së Islamit, burimi fundamental i metafizikës islame, i kosmologjisë, i teologjisë, i së drejtës, i etikës, i ndërgjegjes së shenjtë dhe i vështrimit të përgjithshëm ndaj botës. Në njëfarë mënyre është shpirti i traditës muslimane që i ngjan mozaikut të ndërtuar me frazat e Kur'anit të cilat përsëriten gjatë gjithë jetës sic janë fjalët BISMILLAHIRRAHMANIRRAHIM e me këtë frazë fillojnë dhe u dedikohet të gjitha punëve legjitime {të lejuara} Me frazën ELHAMDULILLAH QË DO TË THOTË FALENDEROJME Zotin kryhen punë ose ngjarje duke e falenderuar Atë, ndërsa fraza INSHAALLLAH, në dashtë Zoti, përcjell cdo dëshmi, thënie që lidhet me të ardhmen sepse e ardhmja është në dorën e Zotit. Madje edhe cdo përshëndetje ditore e muslimanëve. ESSELAMU ALEJKUM, paqja qoftë mbi ju, vjen nga Kur'ani. Ashtu sic kanë vërejtur disa

shkencëtarë perëndimorë të Islamit, nuk ekziston ndoshta asnjëlloj libri në cilindo religjion qoftë, që të jetë kaq ndikues sa c'është Kur'ani në Islam

Që të kuptohet plotësisht përmbajtja e Kur'anit nga perëndimori që ndjek kristianizmin, ai duhet të kuptojë që Kur'ani, me mendimin e përzgjedhur mund të krahasohet {radhitet} me Dhjatën e Vjetër e të Re e, më thellë mund të radhitet edhe me vetë Krishtin. Në Kristianizëm edhe shpirti edhe trupi i Krishtit janë të shenjta, Krishti konsiderohet si fjalë e Zotit. Për muslimanin Kur'ani është fjalë e Zotit dhe të dyja; kuptimi i tij i brendshëm ose shpirti dhe trupi i tij apo forma e jashtme, teksti në gjuhën arabe me të cilën është zbuluar, janë të shenjta për muslimanët. Sido që ta konsumojnë bukën ose verën të cilat kristianët i konsiderojnë si simbole të gjakut e trupit të Krishtit, po kështu muslimanët shqiptojnë fjalën e Zotit në cdo lutje ditore duke përdorur të njëjtin organ të trupit, gojën. Në Islam thuhet se Zoti cdo të Dërguari i jep nga një mrekulli që i përgjigjet asaj që është më e rëndësishme për atë kohë.

Meqenëse magjia ishte shumë e rëndësishme në Egjipt, Zoti i dha Musait a.s. mundësinë që të tjetërsojë shkopin e vet në gjarpër. Medicina ishte shumë e rëndësishme në kohën e Krishtit, Zoti i dha atij mrekullinë e ringjalljes së të vdekurve. Dhe, meqenëse elokuenca poetike ishte dicka që vlerësohej më tepër se cdo dituri tjetër në kohën paraislamike tek arabët, Zoti i reveloi të Dërguarit atë që ishte më elokuentja e cdo veprë arabe. Në të vërtetë, pohohet se recitimi i Kur'anit është mrekullia më e madhe e Islamit. Recitimi i Kur'anit jo vetëm që e ka vënë në lëvizje zemrën dhe shpirtin e arabëve të atëhershëm, në shëk. e 7të, por edhe i fton besimtarët e gjithë botës sot që të shkrehen në vaj, madje edhe ata që gjuhën arabe nuk e kanë gjuhën e nënës. Për muslimanët Kur'ani, është burimi i gjithë diturive, është themeli i Ligjit, udhërrëfyes i natyrshëm për sjelljen me etikete dhe rrjetë me të cilën peshkatari Hyjnor e kap shpirtin njerëzor dhe ia kthen përsëri Njëshit.

LUTJA DHE GNOSTIKA (Njohja)

Në shumë versete kur'anore, në kontekste të ndryshme, përmbledhet lutja, kur kemi parasysh sic thotë Kur'ani që njeriu është krijuar i dobët: *"وَ خُلِقَ الْإِنْسَانُ ضَعِيفًا"*, -Ve hulumto insani daifem..atëhere njeriut i duhet lutja, madje lutja e sinqertë me të cilën ai i drejtohet Allahut të vet dhe vetëm nga ai ndihmë kërkon.

Në Islam nuk ka ndërmjetës ndërmjet Allahut dhe njeriut.

Fjala lutje buron nga arabishtja dhe është formuar nga folja de'a, jed'u.dua {lutja} përkthehet thirrje, ftesë, gishje, apel, lutje falenderim....

Vetë Kur'ani përmban shumë lutje dhe surja e parë e Kur'anit El-Fatihaja, dhe dy suret e fundit të Kur'anit janë lutje, kështu që Kur'ani fillon dhe mbaron me lutje.

Allahu në suren el Bekare ajeti 186.thot:

وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ

“Kur robërit e Mi {besimtarët} të pyesin për Mua, Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.” Allahu, sic thuhet në ajetin e cituar, është afër besimtarëve të vet dhe Ai u përgjigjet lutjeve të tyre dhe ne si krijesat e tij jemi të detyruar që të dëgjojmë e t'i përgjigjemi thirrjes së Tij dhe tek ai të besojmë fort. {qëndrueshëm}. Kur'ani përmend dhe lutjet e të dërguarve si p.sh: atë të Nuhut, Ibrahimit, Zekerijjas, Jusufit, Idrisit, Jakubit, Jusufit dhe Muhammedit s.a.

Kur'ani jo vetëm që ka porositur lutjen drejtuar të dërguarve të vet, por edhe e ka urdhëruar atë sic thuhet në ajetin 60 të sures Gafir: عَنْ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ

عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ

<Zoti juaj ka thënë: <Lutmuni Muase do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë ata që tregohen mendjemedhenj e nuk duan të më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehennem të poshtëruar> Lutjet me të cilat i drejtohem i madhit Zot mund të bëhen me emra të ndryshëm sic thuhet në ajetin 110 të sures Isra: قُلِ ادْعُوا اللَّهَ أَدْعَاؤَ اللَّهِ... قُلِ ادْعُوا اللَّهَ <Thuaj: Thirrni Allahun ose thirrni të Gjithëmëshirshmin, me cilindo emër që ta thirrni ju, Ai ka emrat më të bukur.>

Libri i Frithjof Schuona <Të kuptuarit e Islamit> {në burimin francez Comprendre l'Islam ose në përkthimin anglisht Understanding islam} merret me {trajtimin} themelet e aspektit religjoz >, kreu i fundit i kushtohet misticizmit islam. dhe thotë: <Njohja e intelektit do të thotë njohja e përmbajtjes, e thelbit {konsupstancial} dhe sipas kësaj, pra është vetë natyra e gjërave; ky është shkaku që fjala e urtë greke thotë: <Njihe veten> ndërsa në Ungjill thuhet: <Mbretëria qiellore ndodhet te ju> dhe Islami kumton: <Kush njeh veten, ka njohur Zotin e vet>.

Kështu feja {në kuptimin më të gjërë, imani} ngërthen, zotëron, dy pole; <njëri objektiv dhe i jashtëm dhe tjetri subjektiv dhe i brendshëm; bekimin dhe inteligjencën.

{zgjuarsinë}.Shpalljamund, ka forcën ta bëjë serioze inteligjencën e cila është errësuar , shkatërruar, por nuk është e ndërprerë me rënien e njeriut.¹

Nuk ka dyshim që lutja mund të ndikojë mbi atë që është e paracaktuar. Por edhe ky ndryshim për shkak të lutjes gjithashtu është i paracaktuar. Mos mendo ti që t'i lutesh Allahut për dicka që nuk është e paracaktuar. Lutja është parashikuar dhe gjithashtu edhe rezultati. Kështu lutja ndikon , por ajo nuk ndikon në atë që është përcaktuar , sepse ajo është shënuar sipas procedimit dhe mjeteve ndihmëse.Cdo gjë është e përcaktuar nga Allahu xh.sh. Gjithashtu, me lejen e Zotit xh.sh.të gjitha veprat , proceset, ndikojnë te pasojat. Sipas kësaj edhe veprat, edhe rezultatet janë të paracaktuara.²

Për ceshtjen e lutjes, i dashuri im,prof. dr.Hilmi Neimarliu do të thoshte se lutja vjen atëhere kur është jasht mundësive tona, jasht fuqive tona; të qenët i ruajtur respektivisht i lidhur me fenë, përfshin dituri {njohje} shumë më të gjëra se sa kryerja e adhurimeve të përditëshme fetare e kjo do të thotë:<të jeshë i ruajtur do të thotë të zotërosh , para së gjithash, besimin e vërtetë dhe të fortë dhe besimin e bazuar

në prova dhe argumente të pakundërshtueshme.Të jeshë i ruajtur do të thotë të zbkurohesh me sjellje të mira dhe e pozitive, gjë që është morali.Të jeshë i ruajtur do të thotë të jeshë anëtar i vlefshëm i shoqërisë, i shoqërisë ku jeton.Të jeshë i ruajtur do të thotë të jeshë aktiv, këmbëngulës dhe i durueshëm në jetën e përditëshme me problemet dhe kërkesat e saj. Një njeri i tillë, i ruajtur

në këtë kontekst që e përmendëm më lart, e gjen lehtë mënyrën që ta tregojë përulsinë, besnikërinë dhe dashurinë e vet ndaj fesë që mbart në zemrën e vet.³

ROLI KRIJUES I LUTJES DHE LUTJET NË JETËN E NJERIUT

Një ceshtje shumë thelbësore për të cilën paralajmërojnë shkencëtarët muslimanë e ndërmjet tyre edhe imam Khomejni.Këtë e ka shëruar nga sëmundja dhe ankimet për shkak të ndarjes{nga atdheu dhe familja}leximi i Kur'anit dhe meditimi për lutjet.Themelimi, vendosja e lidhjes ndërmjet lutjes dhe shpalljes, nga njëra anë, dhe të kuptuarit e diturisë në anën tjetër, duke i pajtuar dhe vendosur paralel, rrafsh, në mënyrë që forcimi i një nevoje nuk kërkon mohim e tjetrës. Një mohim i tillë ndodh atëhere kur lutja dhe religjioni nuk i përmbahen logjikës, shkencës dhe arsyes. Ai paralajmëron që <arsyeja dhe shpallja>,<përkushtimi religjioz dhe matura>dy krahë të nevojshëm të njeriut që dëshiron

¹ Frithjof Schuon –‘Të kuptuarit e Islamit’, autor Martin Lings El-Kalem,Sarajevë 2008}

² Sheh Muhammed bin Salih bin Usejmin, Fatava Arkan-il –Islam f.124

³ Enes Karic, Hermeneutika Kur’ana,Zagreb, 1990

përsosmërinë. Në kohën kur leximi i Kur'anit dhe lutja konsideroheshin si punë e të papunëve, kur madje as në institucionet arsimore teologjike komentuesit e Kur'anit nuk konsideroheshin si elitë profesorësh, kur prania dhe pjesëmarrja në ceremonitë fetare e leximi i lutjeve konsideroheshin si shembuj të padenjë të dijetarëve dhe profesorëve të universiteteve, Khomejni si dijetar dhe mendimtar, intelektual aktiv, politikan i fuqishëm, drejtues islamik dhe luftëtar aktiv ka apeluar për rolin dhe rëndësinë e lutjes në formimin shpirtëror të njeriut. Në veprën e tij të parë <Komentim për lutjen e mëngjesit> ai i fton ata që synojnë përsosmërinë duke menduar për këtë thesar hyjnor. Në veprën e tij ai i këshillon ithtarët me udhëzim dhe pastrim që të mos harrojnë këtë thesar të pasur me dobi të jashtzakonshme në rrugën e përsosmërisë së njeriut.

Në një vëllim të librit⁴ ku flet për thëniet Kur'anore dhe lutjet, duke iu referuar fjalës Sa'ad, imami thekson: „n.q.s Kur'ani është shpallje e fjalëve dhe e të vërtetave që është zbuluar nga madhësitë më të larta në zemrën e të Dërguarit s.a.s.a., atëherë në të vërtetë fjalët e lutjes janë ushqim dhe furnizim për rrugën shpirtërore {të profetëve të Zotit} e cila pas udhëtimit shpirtëror nëpër emrat e nderuar të Zotit xh.sh. në fund të rrugës nëpërmjet katër etapave irfane, do të begatohet me gjurmët e njerzillëkut dhe me ata që janë nisur në autostradën e udhëzuar.

Sipas kësaj thelbi i lutjes s'ka asgjë të re. Kuptimi i saj nuk ka përcaktim kohor. Ndërkohë, me përpunimin shkencor, lutja ka njohur formë dhe cilësi të re. Leximi i Kur'anit dhe lutja u jep besimtarëve forcë dhe nxitje për veprimtari dhe nuk i përgjum ata. Ata duke lexuar fjalët qiellore të Kur'anit dhe lutjet ecin në rrugën e drejtë dhe te përsosmëria shpirtërore me hapa të shpejtë duke kaluar brenda një natë 100 vite largësi. Duke përfunduar për lutjen në veprën <Komentimi i lutjes së mëngjesit> Imam Khomejni thotë: <Lutja është lidhja shpirtërore ndërmjet Krijuesit dhe krijesës, është tokë, {rryp, lidhëz} ndërmjet atij që do dhe Atij që duhet. Ajo {lutja} është mjet kalimi ndërmjet fortesës së qëndrueshme Hyjnore, nyje e fortë që lidh njeriun tokësor me botën universale.⁵ {Imam Ruhullah Khomejni, Sharh Do'aye Sahar, shtëpia botuese Feyd, f.32} Pas kësaj Imami tregon dicka {vepër, punë} shumë të rëndësishme dhe kjo është se vetëm shqiptimi i fjalëve nuk mund të jetë thelbi {edhe n.q.s. ai ka një qëllim dhe kuptim, sepse kur lëvizim gjuhën pa u menduar, vetëm përmendja e të Dashurit na dhuron ëmbëlsi dhe bukuri duke na cuar drejt përsosmërisë}. Vlera dhe dobia janë proporcionale me nivelin e diturisë dhe të njohjes së njeriut. Ai udhëtar që nis në rrugën e errët dhe të rrezikshme e ka lidhur bohcen, trastën e rrizkut të vet, në rrugën që e con tek i Dashuri,

⁴ Sahife Imam, vëll. 18, f.481

⁵ Imam Ruhullah Khomejni, Sharh Do'aye Sahar, shtëpia botuese Feyd, f.32

ndërsa djalli, armiku i tij i betuar, e prët në pritë me kurthin e përgatitur. I dashuri {Ma'shuk} është roje dhe mbrojtës i të dashuruarit {ashikut} dhe i atyre që ecin në rrugën e tij. Adhurimi në filozofinë e Imam Khomeinit zotëron një cilësi dhe manifestim të ri. Nuk është ky një detyrim i zbratur. Sipas mendimit të tij, njeriu që ka arritur shkallën e hakikatit dhe që ka njohur madhësitinë e Krijuesit, bëhet i magjepsur e i ekzaltuar ndaj madhësisë së Krijuesit. Ai që nga thellësia e shpirtit është i dashuruar me të përsosurin, pa asnjë të metë dhe larg nga korrupsioni kur sheh manifestimin absolut të përsosmërisë dhe madhësitinë e të Dashurit, i dorëzohet plotësisht dhe i përfshirë me Bukurinë dhe përsosmërinë e tij, bie në dalldinë dhe përhumbjen dhe i penduar i drejtohet duke ia dorëzuar dëshirat dhe të fshehtat e veta. Adhurimi e ndryshon mendimin vetjak, në vend të lutjes me synim gradimin për kryerjen e adhurimit, falenderon të Dashurin. Kjo është shkalla ku Miku i të dashuruarit të flaktë, që ndodhet në një gjendje plotësisht të pamundur dhe të dobët, i dhuron prirjen e Vet të hapjes së portës së bisedimeve me Te, i Cili është plotësisht i përsosur. Sipas kësaj, adhurimi nuk është një punë boshe i njësuar në një formë të thjeshtë, por ashtu si gjithë gjërat në botën ekzistuese që zotëron formën edhe thelbin {brendinë}, ka dispozitën dhe urtësinë e vet. qëllimi i fundit i tij është ta sjellë njeriun në vendin e skajshëm, respektivisht të hyrja e destinuar posacërisht për të zgjedhurit, afrimi të Miku dhe paqja në mbrojtjen e më të Dashurit.

GNOSTIKA - IRFAN (NJOHJA)

Irfan do të thotë arritje deri tek i Adhuruari dhe fundosja tek Ai, besimi për të vërtetën, nuk ka <la> dhe <vec>, vec Atij asgjë të mos shohësh dhe asgjë të mos dëgjosh, kapërcimi i gjendjes e <diturisë së sigurtë> {gjendja e njohjes së shariatit} gjendja e tejkaluar <besim i padyshimtë> {gjendja e njohjes dhe sinqeritetit në shariat} dhe hyrja në një gjendje më të lartë, <njohja e vërtetë> {gjendje plotësisht e bindjes dhe zhytja tek e vërteta} kalimi nga gjendja formale në gjendjen e brendëshme. Dukja e jashtme dhe mjetet njihen nëpërmjet shkencës, të vërtetat e tyre kuptohen me arsye, përderisa vetëm me irfan kuptohet ekzistenca e tyre. Në të vërtetë, kjo do të thotë që Irfani është hulumtim dhe arritje e qëllimit respektivisht, shmangia, largimi i perdes dhe jo mbledhja e librave {formalizmi} ⁶

Në kontekstin e një kuptimi të tillë të fesë zhduket cdo formë hipokrizie. Këtu nuk ka vend as ai që kupton objektin e të kuptuarit as ai që di objektin e diturisë, në majë të irfanit nuk ka as dëshmitar as objekt kandisjeje. Në këtë moment njohja ngrihet në një shkallë ku asgjë nuk shihet përveç bindjes dhe manifestimit të Tij, ngrihet në një pikë ku kuptohet se nuk ekziston

⁶ Kasani, Abdurrezzak, Sharh Menazl al sairin, komentator i Mohsan Nedarifar, shtëpia botuese Nidar f.294

as ai që bën ziqër as ai të cilit i bëhet ziqër, përderisa është përcaktuar ai që lavdëron dhe atë që lavdërohet për pamundësinë e tij, për atë që realisht {në të vërtetë} <ai që lavdëron> është njëlloj si ajo që lavdërohet. Falenderimi i vërtetë {falenderojmë Zotin e merituar} është i pamundur për atë që lavdëron.⁷

.Thënë më qartë Irfan është një kalim, kalim nëpër botën e ndjenjës e të të kuptuarit dhe këto arritje deri te e vërteta e pastër dhe e plotë dhe njohja e saj. Irfani është një lëvizje dinamike dhe e lartë; kjo është përpjekja dhe mundimi; kjo është luftë dhe xhihad; xhihadi si luftë e pandërprerë investimi i mundimit me qëllim për t'u cliruar nga robëria, clirimi nga sundimi i nefsit {luftë e madhe} dhe largim nga armiku fizik {xhihadi i vogël}

{Arif} Njohja është luftëtare e guximshme që lufton në dy fushëbetejat. Ky është i dashuruar që mendon vetëm për të Dashuruarin dhe që kërkon dhe e do vetëm Atë. Me që {arifi} njohja nuk mund të vendosë poshtërsinë, pushtetin e prishur, tiran dhe autokratik, xhihadi këtu fiton kuptimin e vet të vërtetë dhe argumenton lidhjen origjinale me irfanin. Arifi është muxhahid dhe trim. Ai është luftëtar, trim që nuk ka qëllim tjetër vec arritjes së përsosmërisë, arritjes në shkallën e lartë shpirtërore dhe zhdukjen të Përjetësia e Absolutja. Njohja, e cliruar nga cdo shtrëngesë, ia njeh njeriut vlerën e tij të madhe, e konsideron zëvendës të Zotit mbi tokë dhe asnjëherë nuk do të lejojë që një qenie të tillë ta drejtojnë dëshirat, tekat {në dimensionin shpirtëror} dhe shërbesat dhe dredhitë e djallit {në dimensionin e jashtëm fizik}. Në sytë e njohjes, njeriu është palca, thelbi dhe qenie e botës dhe ekzistencës. Ai është zbukurimi i ekzistencës. Është syri nëpërmjet të cilit Zoti vëzhgon botën.⁸

Natyrisht, ai {njeriu} është krijesa më e përzgjedhur dhe më e vlefshme. Sigurisht, në asnjë rast nuk duhen krahasuar këto vlera dhe statusi me ato që përfaqësojnë humanizmin. E dimë që humanizmi, dashuria për njeriun është lëvizje mendore e fillimit të shek. të ri në Europë që synonte të ngrinte {të lartësonte} dinjitetin dhe shembullin {pamjen} e njeriut. Pjesa më e madhe e ithtarëve të këtij mendimi u përfshi nga protestanizmi. Qëllimi i njohjes është realizimi i pushtetit të së Drejtës mbi trupin dhe shpirtin e njeriut. Është e qartë, madje edhe pa e përmendur fare, se për krijimin e këtyre idealeve duhet që përherë të investohet mudi, në luftën xhihad. Qëllimi i njohjes është përsosmëria e njeriut nga momenti në moment. Ky është process i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Kjo është një lëvizje evolucioniste për plotësimin e dy komponenteve të njeriut, të atij shpirtëror dhe trupor. Trupi i njeriut është kafsha që shërben për lartësimin e shpirtit, prandaj ai duhet të mendojë për përmirësimin e

⁷ Sharh Qyseyri bar Fusus al_hikem, komentues i hyrjes në vepër f.48

⁸ Muhyid ad-Din Arebi, Fusus al-Hikem, Fes Ademi f.50

kafshës së vet hypëse. Mos e dhëntë Zoti që vetë ai {trupit} të shndërohet në qëllim i mundimit të vet duke u shndërruar kështu në grackë dhe burg. Është e qartë që tjetërsimi i trupit në burg të kërkesave të nefsit do të thotë rënie në nivelin më të ulët të ekzistencës gjë që gjithësesi nuk është e denjë për njeriun. Sipas pikëpamjes së Imam Khomeinit, njeriu është skenë e konfliktit mes dy ushtrive, të Zotit e djallit. Që të fitojë mbi ushtrinë e djallit, ushtria e Allahut duhet të luftojë pa ndërprerje.⁹

Natyra njerëzore dhe feja e tij varen direkt nga shkalla e diturisë së tij, nga informacioni, arsyeja, liria dhe liria e mendimit. Liria dhe liria e mendimit janë vecori që i mundësojnë njeriut lartësimin shpirtëror dhe arritjen e shkallës së lartë për të cilën është i denjë. Liria dhe liria e mendimit kërkojnë {përbëhen} nga dy korniza: a-shpirti dhe puna b-shoqëria.

Që të kemi liri dhe liri mendimi duhet vazhdimisht të përpiqemi e të luftojmë. Liria dhe liria e mendimit arrihen me përkushtim të plotë e këmbëngulje për të vërtetën absolute të Të Dashurit dhe të Të Adhuruarit.

Porosia e njohjes {irfanit} është e barabartë me porosinë e Islamit, ajo buron nga bindja ndaj vetë Zotit. Njohja e Islamit të vërtetë arrihet me njohjen e irfanit. Prandaj është e pritshme që irfani me qëllimet e tij metafizike të lartësuara është gjendur nën goditjet e suitës së jobesimtarëve, të thesarit financiar, të tiranëve dhe hipokritëve. Ithtarët e irfanit ofrojnë porosi të qartë që, kur ata të ngrihen kundër fesë sonë edhe ne do të ngrihemi dhe do t'i kundëvihemi dynjallëkut të tyre. Kjo fe, sipas mendimit të tyre duhet të jetë shtrembëruar dhe njollosur me bestytini dhe risi që të zhduket forca e saj tërheqëse dhe mos t'u dëmtohet dynjallëku i tyre. Le të themi që irfani i Imam Khomeinit kundërshton asketizmin, izolimin nga shoqëria, letargjinë, përtacinë, egocentrizmin, pakujdesinë, kompromiset me tiranin dhe miraton rindërtimin e shoqërisë fisnike që do t'i korespondojë fisnikërisë dhe dinjitetit të njeriut, si qëllim final i shkencës së njohjes. Sipas kësaj, shoqëria ideale dhe futja e saj në praktikë, janë rrënjët e duhura si një vend dhe urë e lartësimit të dinjitetit dhe të njeriut të ndershëm në lartësitë shpirtërore. Rrjedhat historike na argumentojnë që vlerat e vërteta njerëzore nën ndikimin e rrethanave të përcaktuara e, disa prej tyre i kemi përmendur, e disa prej tyre humbasin në intensitetin dhe përjetojnë rënie, ndërkohë ata asnjëherë nuk humbasin shkëlqimin dhe universalitetin e tyre. Vazhdimisht dalin reformatorë dhe rilindas të cilët mënjanojnë hirin nga prushi dhe përsëri e ndezin këtë zjarr. Në këtë kontekst unë do të rendisja Khomeinin si shembulli më i mirë i këtyre reformatorëve që ringjalli fenë dhe vlerat

⁹ Imam Ruhullah Khomeini, Sharh Cenel Hadith, shtëpia botuese Tanzim va Nashr Ashar Imam Khomeini f.5

e saj. Ai urdhëronte që feja të bëhet ajo vlerë që të dominojë në jetën e njeriut. Fjalët dhe porosinë e tij asnjëherë nuk kanë qenë të kufizuara vetëm në shoqërinë e tij. Porosinë e tij janë universale. Ai ka folur qartë: <Unë informoj, njoftoj botën.....>

Si reformator ai ia ka paraqitur botës irfanin e vërtetë dhe të pastër. Në letrën historike të drejtuar njërit prej liderëve të femohimit dhe ateizmit {president i BRSS, Gorbacovit} ai e porositi dhe i rekomandon librin <Fusus al-Hikem> të Ibni Arebiut, themeluesit të irfanit spekulativ. Imami nuk e diferenconte muslimanin nga arifi. {njohësi}. Ai e mbronte irfanin nga shtremberimet dhe nga vendosja e njollave mbi të. Imami paralajmëronte se irfani i kundërvihet cdo lloj përluljeje, egocentrizmit, asketizmit, izolimit nga shoqëria dhe se është i papajtueshëm me cdo lloj shfrenimi dhe flakjen e formave fetare. Irfani është njohja dhe vetëdija, irfani i dashurisë dhe i entuziazmit që do të thotë të mos shohësh asgjë përveç të Dashurit {Zotit}, të mos bësh asgjë që s'është në përputhje me kënaqësinë e Tij. Kjo është lëvizje rreth strumbullarit <Allah>, pajtim me karvanin e universit që dëshmon se <Nuk ka Zot tjetër vec Atij>. Arifi {njohja} është njeriu të cilin largësia nga i Dashuri e bën të gjallë {dinamik}, e bën cdo moment më të flakët në pritjen e të Dashurit {Zotit}; ky është muslimani që ka gjetur rrugën drejt përsosmërisë islame. Fillimi i rrugës së tij është natyra. {kthimi në natyrën e vërtetë njerëzore}. Qëllimi i fundit i udhëtimit të tij është gjithashtu natyra, natyra me të cilën është i dashuruar {ashik}, përsosmëria absolute e tij dhe rezultat i dashurisë [ashk} Sipas kësaj, lëvizja khomeiniane, porosia, dukuria dhe entuziazmi, poezia por edhe revolucioni burojnë nga irfani i tij, mbështeten mbi të dhe marrin forcën nga ai. Me fjalë të tjera, e tëra kjo është manifestimi dhe shprehja e irfanit të tij. Ai me modesti e ka ftuar {thirrur} popullin e vet në rrugën e brendëshme shpirtërore, në rrugën e brendëshme vetjake e të natyrshme i ftonte dhe thoshte <O njerz! Ju nuk jeni krijuar për shkak të asgjësë, për t'u përlulur dhe për t'u përbuzur, për t'u robëruar, por jeni krijuar të jeni të përjetshëm dhe të arrini tek i Adhuruari Absolut. Përjetësia arrihet atëhere kur të clirohëni nga errësira e pashmë, nga dëshirat, kërkesat dhe tekat dhe nga shërbimet tokësore të satanait. Shejtanin, armiku i betuar që ka përgatitur kurthin për ju, fshijeni nga zemra juaj që është qendra e njohjes dhe vendi i manifestimit të Zotit sepse shpëtimi është i mundur ekskluzivisht nga një punë e tillë e cinguar. Asnjëherë në emër të udhëheqësit drejtues fetar, të fesë dhe të irfanit nuk i ka mbyllur sytë para realitetit dhe pengesave që ndodhen në rrugën e zhvillimit dhe lartësimit shpirtëror të njeriut. Indiferenca dhe bindja ndaj tiranëve konsideroheshin si mëkate të pafalshme. Kur ndjente rrezikshmëri, ndërpriste leksionet e diskutimet për të drejtën islame dhe udhëheqjes së drejtë fetare islame. Mbulohej me një bruc {plaf, xhybe, gunë} dhe shkante në tokat europiane. Edhe n.q.s. njeriu ishte i lidhur me xhaminë, me medresen, me mihrabin dhe me minberin, duke i konsideruar si vende nga ku propogandohej e inkurajohej feja, i linte

ato kur e kërkonte situata. Ishte i ndërgjegjshëm për rrezikshmërinë se mjetet {xhamia, mihrabi} nuk ishin qëllim në vetvete. Rrezikshmëria ishte shumë e madhe nga që mjetet {vendet} ishin të shenjtë. Kur imami shihte se i ngushtohej hapësira ai bëntë hixhretin {largohej}. Ka bërë hixhretin nga qyteti i shenjtë, në shenjtërinë e të cilit ai besonte me tërë qenien e tij, ku ai cdo mbrëmje në të njëjtën kohë mbi varrin e prijësit të dashur kalamendej {gjunjëzohej} nga respekti për të. Madje edhe sëmundja nuk e pengonte të shkonte për vizitë te prijësi i vet paraardhës. Ai pa u menduar fare i ndërpriste leksionet që ishin frut i punës shumëvjecare, frut i mundit, studimit dhe diskutimeve dhe drejtohej për në Perëndim. Ai i dedikohej idesë së inkurajimit, nxitjes së Islamit duke kërkuar dinjitetin dhe krenarinë e muslimanëve. Kështu fytyra e Islamit të pastër ndricoi me shkëlqim të ri duke zgjuar frymë të re. Të jeshë musliman nuk do të thotë të jeshë mizerje e më pak i vlefshëm, por krenar dhe i nderuar. Thirrja e tij na kujton, në këtë që sot, Zoti mos e dhëntë, të mos na gënjejë pasurimi, shkëlqimi, dhe përparimi material i Perëndimit. Bëhuni të ndërgjegjshëm se Islami është feja ku ithtarët e saj, muslimanët, duhet të jenë krenarë dhe se nuk duhet ta konsiderojnë veten të dobët dhe pak të vlefshëm. Islami është feja që për arsye të përsosmërisë së saj, dhe gjithëpërfshirjes së kuadrove do të marrë levën e udhëheqjes së botës. Prandaj ithtarët e kësaj feje qiellore duhet të jenë të kujdesshëm dhe të vetëdijshëm, duhet të njohin vlerën dhe statusin e vet. Ai nuk i harron ekselencat dhe udhëheqësit paraardhës të fesë, i penduar, me zemër të thyer, në mënyrë atrore i paralajmëron për përgjegjësinë dhe detyrën. Ai u drejtohet me emra dhe kontekste të ndryshme. Ua kujton, rolin dhe përgjegjësinë e rëndë sepse është i ndërgjegjshëm që për shkak të lëvizjes së tij dhe të revolucionit islam në Iran sytë e gjithë botës drejtohen nga Islami. Bota me vështrimin sycelë dhe të kujdesshëm shikon në mënyrë kritike ithtarët e kësaj feje qiellore, si e si të vërtetojë gjithëpërfshirjen dhe përsosmërinë e kësaj feje ose ndërkaq ta flakin tej. Njohja e vërtetë dhe muslimani i ndërgjegjshëm veprojnë në përputhje me kërkesat e kohës së tyre, por asnjëherë nuk dorëzohen dhe nuk bien pre e kërkesave dhe konditave të kohës. Shfrytëzim i momentit përgjegjës dhe i

situatës me synimin për përparimin dhe forcimin shpirtëror është, njëri nga principet e arifit {njohes}. Ai përgatit kushtet në mënyrë që gjërat dhe shfaqjet në shoqëri të manifestohen në formën dhe vërtetësinë e tyre të pastër

Imam Khomeini, duke pasur parasysh harmoninë që sundon ndërmjet sheriatit, tarikatit dhe hakikatit si dhe domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në pajtim me ligjet {dispozitat} islame, mospërfillja, lënia pas dore e sheriatit dhe e dispozitave fetare, për cdo shkak apo pretekst qoftë, madje edhe për shkak të futjes në shkallën e hakikatit, e gjykonte të papranueshëm. Në

komentin e Ibni Arebiut 'Fusus al Hikem' ai thotë qartë:<Ndermjet të jashtmes dhe të brendshmes të dukshmes dhe të brendshmes {të padukshmes}, ndërmjet tarikatit dhe shariatit ekziston një lidhje e pashkëputur.Njëra nga rrugët që e shpie njeriun tek e brendëshmja dhe hakikati është rruga ezbukurimit të së jashtmes, plotësimit të detyrave të shariatit. Sipas kësaj ruajtja e shariatit dhe tarikatit mundëson arritjen e shkallëve të hakikatit.Duke vazhduar më tej ai në mënyrë kategorike thotë:<Kur një person , duke plotësuar detyrat e shariatit dhe duke respektuar formën e tij,nuk arrin tek e brendëshmja dhe në thelbin e gjërave , le ta dijë se gjatë kryerjes së detyrave të veta dhe të urdhërave,diku ka lënë mangut dicka.¹⁰

Njeriu nga vetë natyra është i dashuruar për përsosmërinë dhe nuk dëshiron të mangëtën e jo të papërsosurën.Kur sheh manifestimin e përsosmërisë dhe lartësimin e Mikut,magjepset me Të dhe me bukurinë e tij dhe i dorëzohet entuziazmit të dashur dhe lutjes së pendesës.

Ibrahimi a.s. e drejtoi fytyrën e vet drejt Atij që tokën dhe qiellin i krijoi nga

hici. {mosekzistenca} Kjo është shkalla e parë e njohjes, kjo është dalja nga shirku, shoqërimi i Zotit me një tjetër.Në fazën pasardhëse clirohet ngadalë nga trysnia dhe errësira e botës.Në këtë fazë lind ndricimi i shpirtit-nefsit rububijje {të Zotit}, njohja e Zotit si krijues të botës.Fytyra e shpirtit, ashtu si yjet që ndricojnë në qiell qenien e tij, mbulon vellon.

Ndërtuesi i monoteizmit vëzhgon perëndimin e tij.Pas kësaj hyn në shkallën e <zemrës>, ku hëna e plotë e zemrës nxjerr nga horizonti, qenien e tij. Ai në këtë moment vëzhgon rububijjetin e zemrës {me fjalën zemër kuptohet Zoti i botës, idem dhe fjala rububijjet} dhe e ndjek strehimin e tij nën mbulesë.Nuk do të kalojë shumë kohë , ai përsëri do të shohë rënien dhe perëndimin . {Ka për të njohur kalimin e njohjes së zemrës} Duke kaluar edhe ky stad, përsëri edhe në fytyrën e diellit të shpirtit sheh mbulesën dhe mëson se edhe në këtë stad shkëlqen e kufizuar hyjnia.Ai edhe në këtë stad nuk qëndron {mbahet} dhe nuk ndërton shtëpinë e vet, sepse ai kërkon hyjnizimin absolut, dhe jo hyjnizimin e kufizua¹¹

Të gjitha lutjet fillojnë duke shqiptuar fjalën <Allah> ose <Allahumme>e me këtë njeriu bëhet mikrokosmos,bashkimi, sinteza e gjithë figurave dhe trajtave të botës ekzistuese që krijoi Zoti xh.sh.Sipas kësaj,njeriu është i udhëhequr me <ismi

e'zamom> me më të lartin emër të Zotit që në vetvete qëndron mbi gjithë emrat dhe tërë atributet e që përfshijnë tërë ekzistencën të cilën e drejton. Sipas kësaj, zotëruesi i vërtetë i njeriut të përsosur është vetëm, njëri, vetëm Një Zot.Njeriu si krijesa më e përsosur, kur lutet

¹⁰ Imam Ruhullah,ta'liqat bar Sharh Fusus al-Hikem ve Misbah al-Uns,shtëpia botuese Pasdare Islam,bot i dytë,Qom.,1410,viti hixhri f.201}

¹¹ Sharh Do' aye Sahar, Entesharat Etela'at f.43

dhe kur kërkon dicka duhet ta kërkojë këtë me atë emër dhe me atë vërtetësi e cila përmbledh tërë madhësinë e tij e gjithëpërfshirjen dhe emri i tij i bekuar <Allah> është më i miri emër për udhëheqje dhe mbrojtje për këtë krijesë të Zotit, <njeriun>. Njeriu, me qëllimin e përkushtimit me atributet e mëshirës dhe fuqisë së Zotit mbështetet fort tek emri që njëson tërë atributet e Zotit, atributet e mëshirës dhe të madhësisë, ai me këtë emër të Zotit kërkon udhëheqje për atë që ai e di se emri Allah ruan nën mbrojtjen e tij ata që besojnë dhe ata që i shpëton nga errësira në udhëheqjen e ndritur..... {El-Bekare ajeti 257}.

Në fund si përmbledhje {rezyme} po shënojmë përmbajtjen e ca thënieve.

<O i dashur! Zhvish nga vetja rroben e bindjes ndaj gruas e mikut dhe sado që të jetë e vështirë dhe e rëndë rregullo qëndrimin {gjendjen} tënd {haal..}. Rruga e Ahiretit është e ngushtë, ndërsa rruga e njerzillëkut {insanijetit} është e rëndë dhe ne të shkretët ashtu si merimanga jemi të përfshirë në mendime për plackën dhe gjahun, jemi të shqetësuar dhe të përhumbar ashtu si larva e krimbit të mëndafshit e mbështjellë me fije afshi dhe dëshirash me vështrim të shkëputur nga bota e fshehtë dhe shoqëria që meriton miqësi. Lusim të Madhin Zot xh.sh. të na rendisë ndërmjet atyre që i do dhe të cilët ai i ka dalluar, ata që i udhëheq drejt së vërtetës, ata që i udhëheq dhe i frymëzon që ta thërrasin e ta kujtojnë pa e harruar asnjëherë, ata që mbron nga e keqja e vetvetes deri në atë shkallë sa që atyre s'mund t'u bëhet e dashur asgjë më tepër se Ai, ata që i shpëton te vetvetja deri në atë shkallë sa që të mos munden të adhurojnë askend, vec Atij.